



Telekomi i Kosovës Sh.A

Në mbështetje të nenit 34 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr. 03/L-087, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, Bordi i Drejtorëve të Telekomit të Kosovës Sh.A në mbledhjen nr.43 të datës 27.03.2023 miratoi këtë:

RREGULLORE

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR MARRËDHËNIE PUNE,
nr.01-2978/22 e datës 27.06.2022**

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Marrëdhënie Pune, nr.01-2978/22 e datës 27.06.2022.

Neni 2

Neni 20 i rregullores bazike, ndryshohet dhe zëvendësohet paragrafi 4 nënparagrafi 4.6 me tekstin si në vijim:

4. 4.6 vlerësimi i intervistave.

Në rregulloren bazike nënparagrafit 4.7 i ndryshohet numri rendor me 4.8.

Në rregulloren bazike nënparagrafit 4.8 i ndryshohet numri rendor me 4.9.

Neni 3

Neni 21 i rregullorës bazike, ndryshohet dhe zëvendësohet titulli dhe paragrafi 5, me tekstin si në vijim:

Titulli - Procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve

5. Pas shqyrtimit të vërejtjeve, në përpilimin e listës, Komisioni Përzgjedhës përpilon listën përfundimtare të kandidatëve që do t'i nënshtrohen procesit të mëtutjeshëm të rekrutimit sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 4

Neni 22 i rregullores bazike, paragrafi 2 dhe 3 largohen nga kjo Rregullore.

Neni 5

Neni 23 Mënjanimi i testimit me shkrim për Konkursët e Brendshme – Në Rregulloren bazike shtohet neni 23, paragrafi 1 me tekstin si në vijim:

1. Në rastet e Konkursit të Brendshëm, varësisht nga kërkesat e njësisë kërkuese, Telekomit mund të vendosë që edhe ta mënjanojë tërësisht testimin me shkrim si mjet të rekrutimit. Për këto raste, vetëm intervista përdoret si mjet i rekrutimit. Për praninë ose jo të testimit me shkrim, kandidatët njoftohen zyrtarisht paraprakisht me kohë.

Neni 6

Neni 23 i Rregullores bazike zëvendësohet me numrin e ri rendor 24 dhe paragrafi 1,4 dhe 5 ndryshohet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

1. Për Konkursët e Jashtme, kandidatët e suksesshëm që kanë kaluar testin me shkrim i nënshtrohen intervistës. Për Konkursët e Brendshme, të gjithë kandidatët që i janë nënshtruar testimit me shkrim dhe kandidatët që i nënshtrohen procesit të rekrutimit sipas nenit 23 të kësaj rregulloreje, i nënshtrohen intervistës. Intervista mbahet më së largu brenda afatit prej dhjetë (10) ditësh nga publikimi i rezultateve përfundimtare të testimit me shkrim. Kandidatët njoftohen së paku dyzet e tetë (48) orë para mbajtjes së intervistës. Njoftimi duhet të përmbajë datën, orën dhe lokacionin e mbajtjes së intervistës.

4. Secili anëtar i Komisionit Përzgjedhës mban shënim veç e veç. Shënimet përmbajnë pyetjet e veta për çdo pjesëmarrës në intervistë, përgjigjet, pikët e fituara për çdo pyetje dhe totalin e pikëve. Në afat prej tre (3) ditësh pas përfundimit të intervistës, Komisioni Përzgjedhës, me procesverbal, përpilon listën përfundimtare ku renditen pjesëmarrësit sipas pikëve të fituara nga testimi me shkrim dhe intervista, apo vetëm intervista (sipas nenit 23).

5. Komisioni Përzgjedhës nxjerr vendim me shkrim dhe e njofton Kryeshefin Ekzekutiv dhe DBNj për vendimin e marrë. Nëse Komisioni vlerëson se asnjëri nga kandidatët e testuar dhe intervistuar, apo vetëm të intervistuar (sipas nenit 23), nuk ka arritur rezultat të kënaqshëm, atëherë e prezanton këtë në raport, me një shënim të veçantë.

Neni 7

Neni 24 i rregullores bazike i zëvendësuar me numrin e ri rendor 25, largohet paragrafi 4.

Neni 8

Neni 44 i rregullorës bazike i zëvendësuar me numrin e ri rendor 45 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, ndryshohet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

1.1.7 një (1) ditë pune për çdo rast të dhënies vullnetare të gjakut, duke mos përfshirë ditën e dhurimit sipas ligjit të aplikueshëm.

Neni 9

Rregullohet (rritet për një numër) numri rendor i të gjitha neneve pas numrit rendor 25.

Neni 10

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Bordit të Drejtorëve të Telekomit të Kosovës Sh.A.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

Shpëtim Dobra

